

**S T A T U T**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Vox News" Sh.p.k.**

Sot më datë 27.01.2022 në Tiranë në adresën Rruga Hamdi Garunja 1020, Pallati Viki sh.p.k Shk. D, Ap. 4 D Tiranë, Shqipëri, është i pranishëm personalisht ortaku i vetëm i shoqërisë në themelim "Vox News Albania" Sh.p.k.:

*Z. Erion Habilaj, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 04.07.1984, banues në Tiranë, i identifikuar me numër personal I40704074T.*

Ortaku i vetëm i shoqërisë në themelim deklaron me vullnetin e tij të lirë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve në vijim, duke hartuar Statutin e shoqërisë në themelim "Vox News" Sh.p.k., në bazë të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nr. 9901/2008, për sa vijon:

**Neni 1**

**Emri i Shoqërisë**

- 1.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është emërtuar "Vox News" Sh.p.k.
- 1.2. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") me emrin "Vox News" Sh.p.k. ("sa vijon edhe vetëm Shoqëria").

**Neni 2**

**Selia e Shoqërisë**

- 2.1. Shoqëria e ka selinë ligjore në Tiranë, Rruga "Hamdi Garunja" 1020. Pallati Viki sh.p.k Shk. D, Ap. 4 D.
- 2.2. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë, ose themelimin apo mbylljen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit apo zyra administrative brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe / ose jashtë saj.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 3.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit në QKB Tiranë.

**Neni 4**

**Objekti i Shoqërisë**

- 4.1. Shoqëria ka për objekt:
  - (a) Veprimtari në fushën e mediave të shkruara dhe online, hapjen dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit.

- (b) Botimi, prodhimi dhe shpërndarja e revistave gazetave, fletëpalosje, printime të ndryshme, reklama, banner, sticker dhe materialeve të tjera të lejuara me ligj.
- (c) Konsulencë në fushën mediatike dhe marketing, media buying.
- (d) Auditime e trajnime për gazetarinë multimediale për krijimin e ëëbsite.
- (e) Kryerje komisioni për llogari apo ne emër te shoqërive te tjera qe kane interes për këtë lloj shërbimi.
- (f) Përveç kësaj ne përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm.
- (g) Për arritjen e qëllimit te mësipërm, shoqëria mund te kryeje çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm ne mënyrë qe te ushtrohet objekti i shoqërisë.
- (h) Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera, që ekzistojnë ose do te krijohen në të ardhmen.

## **Neni 5**

### **Kapitali i Shoqërisë**

- 5.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është ALL 100.000 (njëqind mijë Lekë). Kapitali i shoqërisë konsiston në 1 (një) kuotë e cila zotërohet nga ortaku i vetëm si vijon:
- 100% e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga ortaku Erion Habilaj;
- Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.
- 5.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme e miratuar me shumicën e kualifikuar të parashikuar nga Statuti.
- Në rast të një zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcion me kuotën që zotërojnë, me mënyrën e parashikuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- Kurdoherë që një ose më shumë ortakë të heqin dorë plotësisht ose pjesërisht nga e drejta për të nënshkruar për rritjen e kapitalit përkatës ose që nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit të mbetur i paprekur do tu ofrohet si mundësi ortakëve të tjerë në mënyrë proporcionale me kapitalin që zotërojnë. Një zmadhim i mundshëm i kuotave të kapitalit të panënshkruar do të mund tu ofrohet për të palëve të treta të interesuara, përveç kur parashikohet ndryshe nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.

- Palët e treta të interesuara në blerjen e kuotave në kapitalin e shoqërisë duhet të jenë me pëlqimin e ortakëve dhe për këtë arsye propozimi i tyre i blerjes duhet të jetë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast të një nënshkrimi të pjesshëm të kapitalit ajo do të konsiderohet në të gjitha rastet në rritje për pjesën e nënshkruar nga ortakët.
- 5.3. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin pas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me shumicë të cilësuar Statut. Në çdo rast, kapitali nuk do të reduktohet nën minimumin e kërkuar nga ligji. Zvogëlimi i kapitalit mbështetet nga çdo ortak në proporcion me pjesën e mbajtur në Shoqëri.
  - 5.4. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar i saj, nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga pasuri të tjera të konsideruara ose që do të konsiderohen si të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
  - 5.5. Kuotat e kapitalit derdhen në bankë nga ortakët, në llogarinë rrjedhëse në emër të Shoqërisë. Derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë.
  - 5.6. Të gjitha kuotat e kapitalit janë nënshkruar tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë dhe regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë
  - 5.7. Ortakët kanë të drejtën të tërheqin kuotën e tyre që kanë depozituar te kapitali i Shoqërisë, në rastin në të cilin Shoqëria nuk do të regjistrohet në QKB brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të kuotave.

## **Neni 6**

### **Transferimi i Kuotave**

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm ndaj ortakëve të Shoqërisë si me akt midis të gjallëve ashtu dhe me trashëgimi, vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.
- 6.2. Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes të kuotave të shoqërisë. Ortaku shitës si fillim duhet t'i bëjë një ofertë ortakëve të tjerë me letër rekomande me njoftim-marrje, në të cilën të përcaktojë çmimin e kërkuar për shitjen e kuotës së tij. Në këtë rast secili nga ortakët, në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë, gëzon të drejtën e parablerjes duke shprehur interesin brenda nje afati 10 ditor.
- 6.3. Në rast mosmarrëveshesh mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të secilës palë të interesuar, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i miratuar me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes në bazë të vlerës reale të kuotave.
- 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, i cili do të emërohet me shpenzime të barabarta të secilës palë që janë në marrëveshje,

- me kërkesë të palës së interesuar do të zgjidhet nga gjykata e vendit ku ka selinë shoqëria.
- 6.5 Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
  - 6.6 Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, si shitësi por ashtu edhe blerësi, kanë të drejtë të tërhiqen përkatësisht nga shitja dhe blerja. Në këtë rast shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të palës që heq dorë.
  - 6.7 Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit nëpërmjet një akti noterial ortakëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e vlerësimit.
  - 6.8. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet dhe të përfundojë brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore duke filluar nga data e njoftimit të ofertës ose brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, dhe blerësi nuk ka vënë në zbatim këtë të drejtë, shitësi ka të drejtën të transferojë tek palë të treta kuotën e tij.
  - 6.9 I treti blen kuotën në bazë të një kontrate noteriale dhe pas miratimit nga ana e Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të thjeshtë të shoqërisë për veprimin e shitjes.
  - 6.10. Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie ndaj trashëgimtarëve të ndjerit është i kufizuar me dhënien e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme. Në rast kundërshtimi të ortakëve për transferimin e kuotave drejt trashëgimtarëve të të ndjerit, çmimi i shitjes do të caktohet sipas procedurave për transferimin me akt midis të gjallëve si më sipër.

## **Neni 7**

### **Fitimet e Shoqërisë**

- 7.1. Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj.
- 7.2. Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrën në bazë të përqindjeve të nënshkruara dhe kuotës në pronësi. Në çdo rast, fitimi i shoqërisë dhe ndarja e tij duhet të bëhen vetëm në rast se janë paguar detyrimet e tatim taksave, sipas raportit të përgatitur nga personi i ngarkuar nga Administratori për përgatitjen e pasqyrave dhe bilancit ushtrimor.

## **Neni 8**

### **Parashikimet pasurore**

- 8.1. Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së akumuluar tek të tretët. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas

legjislacionit në fuqi dhe mund të zotërojë kuota/aksione kapital në një subjekt tjetër shqiptar apo të huaj, por gjithmonë me objekt dhe aktivitet tregtar të ngjashëm.

## **Neni 9**

### **Përgjegjësitë**

- 9.1. Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe gëzon të drejtat e detyrimit brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e aktivitetit të shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të. Organi administrativ dhe Asambleja e ortakëve ndajnë përgjegjësitë sipas kompetencave të dhëna nga ligji dhe ky Statut.

## **Neni 10**

### **Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë**

- 10.1. Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve të mbledhur në Asamblenë e Përgjithshme të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:
1. ndryshimi i aktit të themelimit statutit;
  2. miratimi i buxhetit vjetor, të raporteve të administrimit, të inventarit, të bilancit dhe llogarive vjetore;
  3. emërimi e shkarkimi i administratorëve, qofshin ortakë ose jo, dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
  4. miratimi i kredive dhe garancive;
  5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen Shoqëria;
  6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së Shoqërisë;
  7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
  8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
  9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
  10. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
  11. vendimi për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  12. vendimi për fillimin apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria, duke autorizuar administratorin e Shoqërisë për të vepruar;
  13. vendimi për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qofte persona fizikë apo juridikë;
  14. vendimi për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre;

15. vendimi për miratimin dhe ndryshimin e procedurës për mbledhjen e asamblesë;
  16. vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
  17. vendimi për shitjen e kuotave të Shoqërisë;
  18. vendime për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
  19. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.
- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në regjistrin e posaçëm ashtu sic parashikohet nga ligji.

## **Neni 11**

### **Asambleja e Përgjithshme**

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me letër rekomande me konfirmim-marrje ose, sipas zgjedhjes së administratorit, nëpërmjet postës elektronike të deklaruar nga ortakët. Adresat elektronike email të ortakëve regjistrohen në bazën e të dhënave të Shoqërisë.
- 11.3. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 11.4. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord për të marre këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit.
- 11.5. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbale. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të mbledhjes dhe Sekretarit që mban procesverbalin, i cili mund të jetë edhe jo ortak apo jo punëmarrës i Shoqërisë, si dhe rezultati i votimit dhe duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari. Procesverbalit i bashkëlidhet lista e të pranishmëve dhe thirrja.
- 11.6. Pjesëmarrja apo votimi në Asamblenë e Përgjithshme mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrën e parashikuar në ligj (email, skype, video dhe të ngjashme). Në këto raste është e nevojshme prania e sekretarit të mbledhjes, i cili zgjidhet rast pas rasti nga ortakët. Secili nga ortakët është i lejuar të përfaqësohet në mbledhjen e Asamblesë së ortakëve nga një ortak tjetër i shoqërisë apo person i tretë, gjithmonë në bazë të një autorizimi me shkrim duke specifikuar, në raste të vecanta, edhe se si duhet votuar. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të Shoqërisë nën kujdesin e administratorit.
- 11.7. Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.  
Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit te

Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e këtij statuti për sa i takon kuorumit dhe shumicës në marrjen e vendimeve.

- 11.8 Asambleja e Përgjithshme, përveç rasteve parashikimeve të nenit 11.9 të këtij Statuti, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë në mbledhje me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- 11.9 Asambleja e Përgjithshme vendos me 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të votave të ortakëve, nëse ortakët që marrin pjesë me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Çështjet për të cilat kërkohet shumica e kualifikuar janë:
- a) Ndryshimet e Statutit;
  - b) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
  - c) Shpërndarja e fitimeve;
  - d) Riorganizimi, prishja dhe likuidimi i Shoqërisë dhe degëve të saj.

## **Neni 12**

### **Administrimi i Shoqërisë**

- 12.1. Administrator i parë i Shoqërisë është:

*Z. Erion Habilaj, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 04.07.1984, banues në Tiranë, i identifikuar me numër personal I40704074T.*

- 12.2. Administratori i Shoqërisë ushtron kompetencat e plota për kryerjen e veprimtarive të administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 12.3. Administratori emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë riemërimi nga asambleja e ortakëve.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të revokojë administratorin para mbarimit të mandatit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit të mandatit, me njoftim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme sipas procedurave të parashikuara në ligj.
- 12.5. Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për Shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratoreve në fuqi, secili nga administratoret mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin dhe do të komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet nga ai të kryera.

### **Neni 13**

#### **Detyrat dhe funksionet e Administratorit**

- 13.1. Administratori kryen detyrat e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë në këtë Statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndër këto përfshihen detyrat e renditura më poshtë.
  1. Të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të Shoqërisë.
  2. Të hartojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar, që do të miratohet në Asamblenë e Përgjithshme.
  3. Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive.
  4. Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raporte për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
  5. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
  6. Administratorët janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë së aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
  7. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
  8. Të përfaqësojë Shoqërinë te të tretët.



9. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
10. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
11. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
12. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçante për veprimtarinë e Shoqërisë.
13. Të emërojë financiarë e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiarë të tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
14. Të mirë administrojë Shoqërinë.
15. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
16. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
17. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
18. Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
19. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
20. Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
21. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrë të thërrasin asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 11 të këtij statuti dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

#### **Neni 14**

##### **Të Drejtat e Shoqërisë**

- 14.1. Shoqëria ka të drejtë:
  1. të kryejë aktivitete në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
  2. të siguroje pasurinë e vet;
  3. të marre kredi në lekë dhe në valutë të huaj nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
  4. të përfitoje nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
  5. të investoje kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
  6. të punësoje punëmarrës vendas ose të huaj;
  7. të ndajë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

**Neni 15**  
**Detyrat e Shoqërisë**

- 15.1 Shoqëria ka si detyrim:
1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
  2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
  3. të sigurojë punonjësit e saj;
  4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
  5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
  6. të respektojë standardet më të larta si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

**Neni 16**  
**Marrëdhëniet ekonomike – financiare të Shoqërisë**

- 16.1 E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj dhe në pasqyrat përkatëse financiare.

**Neni 17**  
**Dokumentat financiare**

- 17.1. Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

**Neni 18**  
**Kohëzgjatja e vitit financiar**

- 18.1. Viti financiar, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit, fillon më 1 janar të çdo viti dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

**Neni 19**  
**Llogaritë rrjedhëse bankare**

- 19.1. Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë pasi çelen nga Administratori i saj. Llogaritë mbahen në Lekë dhe/ose monedhë të huaj dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës. Për hapjen e parë të llogarisë rrjedhëse të shoqërisë autorizohet administratori i parë i shoqërisë.

**Neni 20**  
**Rezervat e domosdoshme**

- 20.1 Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë një pjesë të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme".

## Neni 21

### Dispozita të veçanta

- 21.1. Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

## Neni 22

### Shndërrimi

- 22.1. Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakëve me vendim dhe kuorumin sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

## Neni 23

### Prishja e Shoqërisë

- 23.1 Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkak të parashikuara në nenin 99 të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) dhe për arsyet si më poshtë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas kuorumit dhe votimit të kërkuar nga neni 86 dhe nenit 87 pika 1 e Ligjit nr. 9901/2008;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka ushtruar aktivitet tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës;
- me humbjen e kapitalit të shoqërisë;

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhe të pare detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

- 23.2. Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë, nëse nuk janë derdhur deri në atë moment.

## Neni 24

### Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni

- 24.1 Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe administratorit do të nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në

fuqi.

#### Neni 25


##### Dispozita të fundit

- 25.1. Ky statut përpilohet ne 2 (dy) ekzemplare në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm.
- 25.2 Për regjistrimin e këtij statuti në Qendrën Kombëtare të Biznessit (QKB)n ë në bazë të nenit 26 të Ligjit 9773 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” autorizohet Administratori i shoqërisë, apo persona të autorizuar prej tij, që të kryejë veprimet e duhura pranë QKB dhe çdo institucioni tjetër tjetër publik.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 27.01.2022

#### ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “VOX NEWS” SH.P.K.

Erion HABILAJ

ERION HABILAJ   
(emër, mbiemër, firmë)